

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Tiranë, më 25.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “F.V materiale mobilimi për shërbimin e Patologjisë/ Infektiv për
nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” i ndarë në 2 (dy) lote.**

- **Loti 1. “F.V materiale mobilimi”**
- **Loti 2. “F.V krevat special për pacientët dhe tavolinë e shtratit (përshtatur për krevat pacienti)”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Mobilje dhe pajisje të ndryshme 39150000-8 , Pajisje mjekësore 33100000-1

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS:

Fondi limit: **14,980,000 (katërmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh** ose 162,051.06 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë e një pikë zero gjashtë) EURO pa tvsh i ndarë në 2 (dy) lote.

- **Loti 1. “F.V materiale mobilimi”** me fond limit 4,704,000 (katër milion e shtatëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 50,887.06 (pesëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë zero gjashtë) EURO.
- **Loti 2. “F.V krevat special për pacientët dhe tavolinë e shtratit (përshtatur për krevat pacienti)”** me fond limit 10,276,000 (dhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose 111,164 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) EURO.

*Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 25.08.2026, me kurs këmbimi 92.44 (nëntëdhjetë e dy pikë dyzet e katër) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

(i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa Specifikimet Teknike për Mobilimin e Pavionit të patologjisë janë hartuar nga grupi i projektimit për projektin: “Rikonstruksioni i Pavionit të Pathologjisë Kati III Spitali Rajonal Vlorë me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse

operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bërë në përputhje me nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për këtë lot është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron për këtë lot do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 42 pika 3 dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të lotit 1. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4/c të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit pwr kwtw lot është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë /broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi loti 1 ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog /broshurë /skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / broshurave / skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kjo kerkese ka disa avantazhe pasi permbushja e saj siguron besueshmëri te informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Garanton gjithashtu përputhshmërinë me specifikimet teknike ç'ka siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Kërkesa pwr pwrmbushjen e kwtij kriteri gjithashtu redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog/broshurë/skede teknike do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.3 Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të disponojë stafin me kualifikimet si më poshtë:

Të paktën 1 (një) inxhinier druri, në rast se është prodhues vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

Të paktën 2 (dy) marangozë/ mobilier/ montues mobiljesh vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Të paktën 2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shenim: Kriteri nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumëtimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkohet të dëshmohet nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Punonjësit me specialitetet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Edhe pse procedura është e tipit “Blerje/furnizim mobiljesh”, objektet e prokurimit nuk janë produkte standarde të gatshme, por mobilje që kërkojnë prodhim, montim dhe përshtatje sipas specifikimeve teknike të tenderit dhe të ambientit të AK përfitues. Thënë kjo këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkojnë nga Autoriteti Kontraktor, pra kjo kontrate ka si proces prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Për këtë arsye, prania e stafit të kualifikuar është e domosdoshme për garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat e kontratës. Inxhinieri i drurit është i nevojshëm për të siguruar projektimin teknik, përzgjedhjen e materialeve dhe mbikqyrjen e procesit të prodhimit/montimit, duke garantuar që mobiljet të jenë ergonomike, funksionale dhe të përputhshme me standardet e sigurisë. Pa këtë profil, rrezikohet cilësia dhe jetëgjatësia e produkteve të furnizuara. Ky proces nuk është thjesht dekorativ, por lidhet drejtpërdrejt me rezistencën e mobiljeve ndaj konsumit dhe faktorëve mjedisorë, duke siguruar që produkti final të jetë i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm për përdorim afatgjatë në administratë publike.

Gjithashtu kjo kërkesë është kërkuar vetëm për rastet kur ofertuesi është prodhues mobiljesh dhe jo në rastet kur ai është vetëm tregëtues i tyre.

Objekti i kontratës përfshin furnizimin dhe dorëzimin e mallrave në ambientet e AK përfitues. Për realizimin e sigurt, korrekt dhe brenda afateve të kontratës së procesit të transportit, ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave operatori ekonomik duhet të disponojë personel të mjaftueshëm të specializuar për kryerjen e këtyre proceseve. Prania e punonjësve të ngarkim-shkarkimit është e domosdoshme për garantimin e lëvizjes së mallrave pa dëmtime, respektimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, përmbushjen e afateve të dorëzimit, shmangien e ndërprerjes së vonesave gjatë ekzekutimit të kontratës. Për këtë arsye kërkesa për disponimin e punonjësve të ngarkim shkarkimit konsiderohet e nevojshme për të garantuar ekzekutimin cilësor të sigurt dhe në kohë të kontratës. Numri i kërkuar për punonjësit e ngarkim shkarkimit është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, afatin e realizimit të kontratës prej 30 ditësh. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me realizimin e kontratës pasi mobiljet duhet të shkarkohen dhe vendosen në ambientet e institucionit përfitues duke respektuar afatin kontraktor. Numri i kërkuar është proporcional me volumin e furnizimit dhe kohezgjatjen e tij dhe nuk krijon kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e ofertuesve të mundshëm ekonomikë. Në vijim në kërkesat për kualifikim është kërkuar që OE të mundshëm ekonomikë të disponojnë 2(dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh duke qënë se artikujt objekt prokurimi do të montohen dhe instalohen në ambientet e Ak përfitues. Këto artikuj do të fiksohen montohen dhe nëse nuk është një staf i specializuar atëherë kjo mund të ndikojë në cilësinë, sigurinë dhe jetëgjatësinë e mobilieve. Numri i kërkuar për

marangozë është minimal dhe i domosdoshëm për realizimin e procesit të montimit brenda afatit kohor kontraktual.

Ky numër punonjësish është numri minimal që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësore, të qëndrueshme dhe jetëgjata, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit. Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, objektin ku do të kryhet furnizimi, vendosja/monitimi dhe kolaudimi i mallrave objekt prokurimi si dhe afatin e lëvrimit të mallit. Pra, kërkesa për këto profile nuk është e tepruar, por proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën e objektit të prokurimit, siç parashikohet në LPP dhe RRPP. Këto kërkesa janë vendosur për të krijuar bindjen se kontrata do të realizohet me sukses sipas standardeve të cilësisë dhe funksionaliteteve të kërkuara. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit loti 1, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

KRITERET PËR KUALIFIKIM LOTI 2. “F.V KREVAT SPECIAL PËR PACIENTËT DHE TAVOLINË E SHTRATIT (PËRSHTATUR PËR KREVAT PACIENTI)”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: sipas pikes 2.3

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet,

ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për çertifikimin ISO 13485:2016 "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit lot 2, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e çertifikatës ISO 13485:2016 "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent të prodhuesit, sipas deklaramentit të bërë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

ISO 13485:2016 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore. Ky standard është i nevojshëm përse i përket sigurisë dhe efektivitetit të produkteve, duke përmblusur kërkesat rregullatore dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë. Një ndër aspektet kryesore të ISO 13485:2016 përfshin dhe Menaxhimin e riskut: Fokus në identifikimin dhe

menaxhimin e risqeve që lidhen me sigurinë dhe performancën e pajisjeve mjekësore. Përputhshmëria rregullatore: Sigurimi që pajisjet mjekësore përputhen me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Kontrolli i furnitorëve: Kërkesa për vlerësimin dhe monitorimin e furnitorëve për të siguruar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

Gjithashtu këto kritere gjejnë mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë konformiteti CE (ose deklaratë konformiteti DC), sipas klasifikimit përkatës të mallrave, konform direktivave / rregulloreve të Bashkimit Evropian, të aplikueshme për objektin e prokurimit, ose certifikimin FDA.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku shprehimisht citohet: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe pika 8 e nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues. Certifikatat e konformitetit CE (ose deklarata e konformitetit DC nëse është rasti) ose FDA approval janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë përputhjen e produkteve me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Gjithashtu, duke vijuar arsyetimin për rëndësinë e këtij furnizimi me artikuj që i kanë kaluar testet e prodhimit dhe sigurisë, është e domosdoshme që furnizimet të jenë cilësore dhe konform rregullave të parashikuara nga aktet e BE (për konformitetin CE) ose të Shteteve të Bashkuara (Për aprovimin FDA). Ligjvënësit respektivë të këtyre rajoneve kanë parashikuar se materialet objekt prokurimi (sipas klasifikimit të riskut që kanë), t’i nënshtrohen një vlerësimi konformiteti rigoroz, nga palë të treta (OVK – organizma të vlerësimit të konformitetit), të akredituara, me qëllim që të përmbushin kriteret e cilësisë dhe sigurisë për përdorim tek pacienti fundor. Pajisjet mjekësore si defibrilatorët dhe manekinët e trajnimit përdoren në situata kritike, ku çdo defekt mund të rrezikojë jetë njerëzish. Certifikimi CE ose FDA garanton që pajisja është testuar sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë elektrike, mekanike dhe biologjike. Legjislacioni i BE-së kërkon që pajisjet mjekësore të kenë shenjën CE për t’u tregtuar brenda hapësirës evropiane. Certifikatat tregojnë që pajisja është testuar për funksionalitet, qëndrueshmëri dhe efikasitet. Për defibrilatorët, kjo nënkupton që energjia e shkarkimit është e saktë dhe e sigurt; për manekinët e trajnimit, që simulojnë me realizëm dhe rezistencë të përshtatshme për përdorim të shpeshtë. Në përfundim, kërkesa e mësipërme vlerësohet në përputhje me objektin e prokurimit, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me të.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Licencë/autorizim për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar, i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM -së nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, i cili përcakton kërkesat kryesore për vendosjen në treg të pajisjeve mjekësore, procesin e regjistrimit, vlerësimin e konformitetit, mënyrën e shpërndarjes, inspektimin dhe mbikëqyrjen e kësaj pajisje. Kërkesa përse i përket këtij autorizimi synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të sigurisë dhe shëndetit, përdoruesit dhe palët e treta. Për autorizimin e tregtimit të pajisjeve mjekësore, kriteret e kualifikimit përfshijnë përputhjen me standardet e sigurisë dhe efektshmërisë të përcaktuara nga prodhuesi, si dhe respektimin e procedurave të regjistrimit dhe vlerësimit të konformitetit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin /distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është i përcaktuar në Ligj nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në zbatim të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar, përse i përket kërkesës për Autorizim për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, garanton furnizime të qëndrueshme me gamën e artikujve, të cilët janë tejet specifikë për nga natyra dhe kanë nevojë për siguri në zinxhirin e furnizimit. Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, i cili përcakton kërkesat kryesore për vendosjen në treg të pajisjeve mjekësore, procesin e regjistrimit, vlerësimin e konformitetit (sipas klasës së riskut të cilës u përkasin), mënyrën e shpërndarjes, inspektimin dhe mbikëqyrjen e këtyre pajisjeve. Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të **Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Datë 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “**Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik**”.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit. Në katalogët / skedat teknike të paraqitura, duhet të markohen specifikimet teknike sipas DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmërinë me specifikimet teknike e cila siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021,

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar. Specifikimet teknike janë si më poshtë vijon;

SPECIFIKIMET TEKNIKE JANË SI MË POSHTË VIJON:

Specifikimet Teknike për Mobilimin e Pavionit të patologjisë është hartuar nga grupi i projektimit per projektin: ***“Rikonstruksioni i Pavionit të Pathologjisë Kati III Spitali Rajonal Vlorë”***

Zerat e rradhitura në permbajtje, janë pjesë dhe përshkrime të detajuara të vizatimeve të bëra nga projektuesit si dhe specifikime të tjera të mundshme të kategorive të ndryshme punimesh.

Specifikime teknike shoqëruar me ilustrime përkatëse për pajisjet e sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Emërtimi I Punimeve	Njësia	Sasia
1	Dollap garderober personeli (permasa 510x60x h=240 cm	copë	10
2	Tavolina pune + komode me 3 rafta (150 x 70 x h75 cm)	ml	6
3	Dollap - Raft me konstrukcion mbajtes metalik dhe me veshje melanine (h= 2.2x1m x 0.4m)	copë	6
4	Karrige fikse per zyrat (permasat 48*65*95 cm)	copë	20
5	Karrige per postet e punes (rrrotulluese)	copë	6
6	Krevat Special per Pacientet	copë	84
7	Krevat per Personel	copë	2
8	Divan per Personel 2-vendesh (190x90xH83 cm)	copë	2
9	Karrige,strukturë metalike,tapiceri tekstili,jeshile,71.5x76.5x H75cm	copë	84
10	Tavolina e shtratit (pershtatur per krevat pacienti)	copë	84
11	Tavoline mbledhjeje me konstrukcion mbajtes metalik dhe me syprine druri dim 3m x 1,2 m	copë	1
12	Karrige statike pritje, 3 copë, strukturë metalike, antrasit	copë	1
13	Grila roler	m2	36

Zëri 1: Dollap garderober personeli (permasa 510x60x h=240 cm)



1. Përmasat

- * Gjatësia totale: 5100 mm
- * Thellësia: 600 mm
- * Lartësia: 2400 mm
- * Modulim: segmentuar në module 50–60 cm për akses dhe stabilitet

2. Materiali strukturor

* **Trup dollapi: HPL kompakt antibakterial (High Pressure Laminate) ose MDF i laminuar HPL**

- * Trashësia: 18–25 mm
- * Rezistent ndaj:
 - * lagështirës
 - * dezinfektuesve spitalorë
 - * gërvishtjeve dhe goditjeve

3. Ndërtimi

- * Strukturë modulare me ndarje vertikale
- * Rafte të rregullueshme në lartësi
- * Ndarje të brendshme:
 - * seksion për rroba të varura (me shufër alumini/inox)
 - * seksion për palosje dhe ruajtje sendesh personale

4. Dyert

- * Dyer me hapje 110°–170°
- * Montesha metalike soft-close
- * Doreza metalike inox ose alumini
- * Secila derë me bravë individuale me çelës (opsional master key për administratën)

5. Bazamenti

- * Bazë e ngritur 8–10 cm
- * Material inox ose HPL rezistent për pastrim të lehtë spitalor

6. Higjiena dhe standardi spitalor

- * Sipërfaqe antibakteriale
- * Lehtësi në dezinfektim me alkool/solucione spitalore
- * Pa hapësira të fshehta ku grumbullohet papastërti

7. Ngjyra dhe estetikë

- * Ngjyrë standarde: e bardhë / gri e hapur (RAL 7035 ose e ngjashme)
- * Opsion personalizimi sipas repartit

8. Aksesorë opsionale

- * Etiketa identifikimi për çdo modul
- * Ndriçim LED i brendshëm me sensor hapjeje
- * Ventilim i fshehtë në pjesën e sipërme Detaje teknike:

Zëri 2: Fv.Tavolina pune + komode me 3 rafte (150 x 70 x h75 cm)



Tavolinë pune spitalore me komodinë (150 x 70 x h75 cm)

Përmasa

* Gjatësia: 1500 mm

* Gjerësia: 700 mm

* Lartësia: 750 mm

Konstruksioni mbajtës

- * Strukturë metalike çelik profil 30x30 mm ose 40x40 mm
- * Trajtim sipërfaqe:
 - * pikturim elektrostatik (epoxy powder coated)
 - * ngjyrë e bardhë ose gri e hapur
- * Këmbë me nivelues plastik/rubër anti-rrëshqitje

Sipërfaqja e punës

- * Material: melaminë kompakte antibakteriale ose HPL (High Pressure Laminate)
- * Trashësia: 25–30 mm
- * Rezistencë:
 - * ndaj dezinfektuesve (alkool, klor, amonium kuaternar)
 - * ndaj lagështirës
 - * ndaj gërvishtjeve dhe goditjeve

Komodina anësore

- * 3 sirtarë (rafe)
- * Strukturë MDF/melaminë antibakteriale
- * Shina:
 - * metalike teleskopike me hapje të plotë
- * Opsion:
 - * kyçje qendrore me çelës
- * Kapacitet ngarkese: 10–15 kg për sirtar

Standard higjiene spitalore

- * Sipërfaqe antimikrobiale
- * Pa pore (easy clean surface)
- * Rezistente ndaj:
 - * dezinfektimit të përditshëm
 - * kimikateve spitalore
- * Skaje të rrumbullakosura (siguri + higjiene)

Karakteristika funksionale

- * Stabilitet i lartë (anti-lëkundje)
- * Hapësirë ergonomike për karrige mjekësore
- * Mundësi për kalim kabllorsh (opsional)
- * Projektuar për përdorim intensiv spitalor

Përfundimi

- * Ngjyrë standard: e bardhë spitalore (RAL 9016)
- * Sipërfaqe matte (jo reflektuese për ambiente mjekësore)

Zëri 3: Dollap - Raft me konstruksion mbajtës metalik dhe me veshje melanine (h= 2,2x1x 0.4m)



0Dollap / Raft Spitalor

Tipologjia: Dollap raft spitalor me konstruksion mbajtës metalik

Përdorimi: Ambiente spitalore, laboratorë, farmaci, depo medikamentesh

Përmasat

- Lartësia: 2200 mm
- Gjerësia: 1000 mm
- Thellësia: 400 mm

Konstruksioni

Strukturë mbajtëse prej profili metalik të trajtuar kundër korrozionit Konstruksion i fortë dhe rezistent për përdorim intensiv spitalor Nivelim në dysheme me këmbë plastike ose metalike të rregullueshme

Veshja

Veshje me panele melamine cilësore

Trashësia e melaminës: 18 mm

Sipërfaqe antibakteriale dhe e lehtë për pastrim

Rezistente ndaj lagështirës dhe dezinfektuesve spitalorë Organizimi i brendshëm

Pjesa e sipërme me rafte të

hapura Rafte të rregullueshme

në lartësi

Pjesa e poshtme me dyer dhe hapësirë magazinimi

Aksesorët

Mentesha metalike me hapje të butë

Doreza inox ose alumini

Mundësi mbylljeje me çelës

Ngjyra

Ngjyrë standarde: e bardhë / krem

Mundësi personalizimi sipas kërkesës

Karakteristika shtesë

Dizajn higjienik për ambiente spitalore

Cepa të sigurta dhe përfundime

ergonomike

Montim i qëndrueshëm dhe mirëmbajtje e lehtë

Zëri 4: Fv.Karrige fikse per zyrat (permasat 48*65*95cm)

Pëmasat

- Gjerësia: 48 cm
- Thellësia: 65 cm
- Lartësia: 95 cm
- Materiali i strukturës: Metalike
- Materiali veshës: Tekstil
- Ngjyra: Jeshile



Karrige fikse relaksi me dimensione 48x65xH95cm është një element i shkëlqyer i mobilimit për të shtuar elegancë dhe komoditet në ambientin tuaj

Struktura e saj metalike është një element thelbësor i dizajnit, duke siguruar stabilitet dhe qëndrueshmëri për karrigen.

Pamja e tapicerisë jep një ndjesi të sofistikuar dhe të klasës së lartë në ambientin tuaj, duke e bërë karrigen të përshtatshme për shumë lloje dekoresh.

Zëri 5: Fv.Karrige per postet e punes (rrotulluese)

Karrige rrotulluese për zyrat (permasat 65*70*94-120 cm)



Specifikime teknike

- Gjerësia: 65 cm
- Thellësia: 70 cm
- Lartësia: 94-120cm
- Materiali i strukturës: Strukturë najloni
- Materiali veshës: Rrjetë dhe tapiceri tekstili
- Ngjyra: E zezë/Portokalli

Kjo karrige kombinon komoditetin me cilësinë. Mbeshtetësja prej rrjete si dhe ulesja e rehatshme ofrojnë komoditet gjatë qëndrimit tuaj në karrige. Lartësia e regjistrueshme dhe bazamenti i rëndë me pesë rrota e bëjnë këtë karrige të pa krahasueshme. Koleksioni i karrigeve është zgjedhja më e mirë për komoditet në hapësirën tuaj.

Zëri 6: Fv.Krevat Special per Pacientet



Krevat Special per Pacientet

- Krevat spitalor (semi-elektrik)
- Mundëson kontrollimin elektronik të ngritjes së këmbëve & shpinës
- Lartësia e krevatit rregullohet manualisht
- Mundëson suport për të sëmurin – për ushqyerje, lëvizje të gjymtyrëve, shikim TV, lexim, etj.
- Lehtësi trajtimi & lëvizje nga stafi mjekësor apo nga vetë familjarët.
- I përshtatshëm për përdorim në kushte spitalore & kushte shtëpiake, nga: të sëmurë kronik, pacientë të cilët po rikuperojnë pas operimit, etj.
- Shtresë komode, mundësi përdorimi të dyshekëve të ndryshëm për komoditet të shtuar.
- Mbrojtëse anësore të lëvizshme
- Strukturë rezistente PP
- Goma në pjesën e poshtme për lehtësi lëvizje.
- Përmasat: 2050 x 960 x 420 – 680 mm Lartësi e rregullueshme: 42 – 68cm.
- Ngritje e shpinës: 0-75°
- Ngritje e këmbëve: 0-35°

Krevat spitalor (Semi-elektrik)

Përshkrimi:

Krevat Spitalor: Aksesori i përshtatshëm për përdorim personal (në shtëpi) & për përdorim profesional (nga stafi spitalor).

Krevati është i përshtatshëm për përdorim nga individë të sëmurë të cilëve iu nevojitet trajtim. I pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për trajtimin tuaj sa më komod.

Lëvizje Elektrike: Krevati spitalor është lehtësisht i përdorshëm,

Gjithashtu, krevati ka kënd të rregullueshëm 0° deri në 75° (shpina) dhe 0° deri në 35° (këmbët) – këndi rregullohet me anë të kontrollueses elektrike.

Rregullimi i këndit mundëson komoditet për trajtimin e pacientit.

Krevati është i pajisur me 4 rrota në pjesën e poshtme. Çka mundëson komoditet transportimi. Secila nga gomat është e pajisur me ndalues – gjë e cila mundëson rritje sigurie.

Material rezistent: Krevati është i ndërtuar me material rezistent aliazh alumin.

Pjesa anësore e krevatit është e pajisur me mbrojtëse për parandalimin e rrëzimit aksidental. Me përmasa:

205cm

(gjatësi),

96cm (gjerësi)

42-68cm (lartësi).

Zëri 7: Fv.Krevat per Personel



Specifikime teknike të krevatit

Tipi: Krevat tek (single bed)

Përmasat e dyshekut: afërsisht 90×200 cm

Përmasat totale të krevatit: rreth 95×205

cm Lartësia e kokës së krevatit: ~80–90 cm

Lartësia nga dyshemeja: ~40–45 cm

Materiali i strukturës: MDF ose melaminë me imitacion druri
natyral Ngjyra: dru i çelët / oak light

Struktura mbajtëse: skelet druri me këmbë metalike cilindrike

Kapaciteti mbajtës: afërsisht 100–150 kg

Stili: modern minimalist

Përdorimi: dhoma studenti, konvikt, hotel, ambient rezidencial

Elemente shtesë që shihen në foto

Kokë krevati e integruar

Dyshek standard single

Komodinë anësore në të njëjtin

material Hapësirë poshtë krevatit për

pastrim

Zëri 8: Fv.Divan per Personel 2-vendesh (190x90xH83 cm)



Specifikime Teknike – Divan Personeli 2-Vendësh

Tipi: Divan 2-vendësh

Përmasat: 190 x 90 x H83

cm Ngjyra: Blu/Gri e errët

Materiali i veshjes: Tekstil cilësor rezistent ndaj konsumit

Struktura e brendshme: Kornizë druri dhe elementë metalikë për stabilitet

Mbushja: Sfungjer me densitet të lartë për rehati dhe qëndrueshmëri

Këmbët: Metalike cilindrike, ngjyrë
argjendi Stili: Modern / minimalist

Kapaciteti: 2 persona

Përdorimi: Zyra, reception, sallë pritjeje, ambient administrativ

Mirëmbajtja: Pastrim i lehtë me leckë të butë ose aspirim
periodik Karakteristika shtesë:

Mbështetëse krah të gjera
Ulëse ergonomike dhe
komode Dizajn kompakt dhe
profesional

Ky stil divani zakonisht përdor tapiceri tekstili dhe strukturë të fortë për përdorim të përditshëm
në ambiente pune.

Zëri 9: Fv.Karrige , strukturë metalike, tapiceri tekstili, jeshile, 71.5x76.5xH75-90 cm



**Specifikime Teknike – Kolltuk / Karrige Lounge me
Mbështetëse Krah**

Tipi: Karrige lounge / kolltuk
individual Stili: Modern / minimalist

Ngjyra: Jeshile ulliri

Materiali i veshjes: Tekstil i butë (bouclé / stof rezistent)

Struktura: Kornizë metalike e zezë

Këmbët: Metalike me finisazh mat

Mbështetëset e krahëve: Të tapicuara për rehati
shtesë Mbushja: Sfungjer me densitet të lartë

Përdorimi: Zyra, reception, lounge, sallë pritjeje, ambiente
moderne Kapaciteti mbajtës: deri në 120 kg

Mirëmbajtja: Pastrim i lehtë me leckë të thatë ose aspirim
periodik Përmasa të përafërta

Gjerësia: 71.5cm

Thellësia: 76.5cm

Lartësia totale: 75–90
cm

Lartësia e ulëses: rreth 45cm

Ky model karakterizohet nga dizajni modern me linja të pastra, strukturë metalike të hollë dhe tapiceri komode për përdorim të përditshëm në ambiente profesionale ose rezidenciale

Zëri 10-Tavolina e shtratit (pershtatur për krevat pacienti)



Përmasat:

1. Gjatësia 900mm
 2. Gjerësia 450mm
 3. Lartësia 770-1050mm
 4. Me majë ABS
 5. Me katër rrota pa zhurmë, dy me frena
 6. Diametri i rrotave të mëdha 6cm
 7. Diametri i rrotave të vogla 3cm
- * Tavolinë që futet poshtë krevatit me bazë “U” ose “H”
 - * Lartësi e rregullueshme (zakonisht ~70–110 cm)
 - * Sipërfaqe e sheshtë për ushqim, lexim, laptop

- * Me rrota për lëvizje dhe shpesh me frenim
- * Material plastikë ABS ose laminat antibacterial
- * Strukturë metalike (çelik i lyer ose inox)
- * 4 rrota (2 me frenim)
- * Tavolinë plastike/laminat (antibakteriale)
- * Disa modele kanë edhe pjerrësi (tilt) për lexim

Zëri 11-Tavoline mbledhjeje me konstruktion mbajtes metalik dhe me syprine druri dim

3mx1,2m



Specifikime Teknike

Të gjitha materialet dhe përbërësit e përdorur në prodhimin e mobiljeve të zyrës janë të çertifikuara dhe në përputhje me rregulloret aktuale.

Modulariteti përbëhet nga dy madhësi të sipërfaqeve të punës të kompletuara me nyje këndore (gjysmërreth ose pjesë e një rrethi) dhe një lloj i vetëm këmbë në formë "Y". Dy versione të disponueshme:

1. Sipërfaqe/lidhje të bëra nga grimca druri ekologjike të klasit E1 me skaje ABS të përputhshme
2. Sipërfaqe/lidhje në MDF me skaje të derdhura, të patinuara dhe të lyera me një përfundim poliesteri.

Zëri 12: Karrige statike pritje, 3 copë, strukturë metalike, antrasit

Specifikime teknike

- Materiali i strukturës: Struktura metalike
- Modeli: 3 copë
- Ngjyra: Antrasit



Këto karrige statike pritje janë një zgjedhje e shkëlqyer për ambientet që kërkojnë një kombinim të bukur midis stilit modern dhe komoditetin. Me strukturën e tyre të qëndrueshme dhe dizajnin e tyre të thjeshtë, ato ofrojnë një zgjidhje elegante për zonat e pritjes të cilat duan të mbajnë një pamje profesionale dhe të modernizuar. Karriget janë të ngjyrës antrasit, një ngjyrë e errët e cila jep një pamje të elegancës dhe stilit modern në ambient.

Zëri:13-Grila roler



Grila rollon kundradielli NIGHT është një zgjidhje e shkëlqyer për të mbrojtur hapësirën tuaj nga rrezet e diellit dhe për të krijuar një ambient më të rehatshëm. Kjo grilë ofron një kombinim unik të funksionalitetit dhe estetikës. Materiali 100% poliestër është rezistent ndaj njollosjeve dhe i lehtë për t'u pastruar, duke garantuar një pamje të freskët për më shumë kohë. Poliestër me cilësi të lartë ndihmon në mbrojtjen e tapicerisë dhe mobiljeve tuaja nga zbehja e shkaktuar nga rrezet e diellit. Me ngjyrat e saj elegante kombinohet lehtësisht në çdo dekor. Instalimi është i shpejtë dhe i thjeshtë, pa pasur nevojë për mjete shtesë. Grila bllokton një pjesë të konsiderueshme të rrezeve të diellit dhe ndihmon në mbajtjen e temperaturës së dhomës më të freskët gjatë verës. Ju mund ta rregulloni lartësinë e grilës sipas nevojës tuaj. Me instalim të lehtë, dizajn elegant dhe funksionalitet të lartë, kjo grilë është një investim i zgjuar për çdo shtëpi.

Ky investim parashikon rrijetësimin e ambjenteve të brendshme të shërbimit të Patologjisë dhe Infektivit dhe përshtatjen e tyre për të akomoduar nevojat e shërbimit të patologjisë dhe infektivit në administrim të Spitalit Rajonal Vlorë si dhe për të realizuar një shërbim cilësor në përputhje me standartet bashkëkohore. Gjithashtu ky investim është përzgjedhur për të përmbushur disa nevoja kritike që lidhen me përmirësimin e kushteve të shërbimit shëndetësor.

Qëllimi i projektit për mobilimin spitalor të shërbimit të patologjisë është krijimi i një infrastrukture moderne dhe funksionale që siguron standartet bashkëkohore spitalore. Projekti synon të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e kujdesit shëndetësor të rrisë efikasitetin operativ dhe të ofrojë një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për pacientët dhe stafin mjekësor. Ky projekt do të kontribuojë ndjeshëm në forcimin e sistemit shëndetësor duke e bërë Shërbimin e Patologjisë një qendër referimi për cilësi të lartë në diagnostikim dhe trajtim si dhe do të ndihmojë në rritjen e efikasitetit të punës dhe kënaqësisë si për pacientët ashtu edhe për personelin mjekësor. Specifikimet teknike të pajisjeve të mobilimit janë përcaktuar sipas dokumentacionit të projektuesit (*planimetria e mobilimit, planimetria e ridimensionimit,*

Render Salla e reanimacionit, Render dhomë pacientësh) duke respektuar kërkesat funksionale dhe standartet e parashikuara ne projekt. Për rrjedhojë këto specifikime teknike janë pjesë integrale e projektit të hartuar nga projektuesi i cili në përbërje të stafit të vet ka edhe arkitekt.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar gjithë

dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*

NJËSIA E PROKURIMIT